



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Ekstra VI

Shtator

2002

Akte të Papublikuara

Janar 1998-Mars 1998

		Faqe
Vendim i K.M nr.5, datë 5.1.1998	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.197, datë 18.3.1996 “Për rrjetin e institucioneve shkencore shtetërore”.....	5
Vendim i K.M nr.25, datë 5.1.1998	Për zgjidhjen e problemit të strehimit të 24 familjeve të fshatrave që përmythen nga ujëmbledhësi i Bovillës, të cilat janë parashikuar të sistemohen në qytetin e Tiranës.....	5
Vendim i K.M nr.34, datë 17.1.1998	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.355, datë 13.5.1996 “Për kryerjen e regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore.....	7

Vendim i K.M nr.36, datë 17.1.1998	Për caktimin e kufirit minimal të regjistrimit për TVSH-në.....	7
Vendim i K.M nr.42, datë 17.1.1998	Për miratimin e statusit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit	7
Vendim i K.M nr.43, datë 17.1.1998	Për organizimin e panairove dhe ekspozitave tregtare.....	12
Vendim i K.M nr.65, datë 30.1.1998	Për kontrollin dhe pezullimin e veprimeve financiare nga llogaritë bankare të personave të lidhur me subjektet e kontrollit “Vefa Holding” sh.p.k., “Silva” sh.p.k “Kamberi” sh.p.k. “Cenaj & Co” sh.p.k. dhe “M.Leka” sh.p.k.....	13
Vendim i K.M nr.73, datë 30.1.1998	Për disa çështje në zbatim të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” , si dhe të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 ‘Për sigurimet shëndetsore në Republikën e Shqipërisë’.....	14
Vendim i K.M nr.76, datë 30.1.1998	Për përdorimin e fondit të grupit “Commodity Aid-22 miliardë lireta”.....	16
Vendim i K.M nr.82, datë 4.2.1998	Për një shtesë në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.356, datë 10.9.1997 ‘Për emërimin e guvernatorëve dhe zëvendësguvernatorëve të Republikës së Shqipërisë pranë institucioneve ndërkombëtare financiare e të zhvillimit’.....	17
Vendim i K.M nr.83, datë 4.2.1998	Për caktimin e ekspertëve kontabël të pavarur dhe të administratorëve në shoqërinë “Gjallica” sh.p.k.....	17
Vendim i K.M nr.91, datë 30.1.1998	Për disa ndryshime në pagat e punonjësve të policisë pyjore dhe policisë së ndërtimit.....	18
Vendim i K.M nr.93, datë 4.2.1998	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.552, datë 26.8.1996 “Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Qeverisë Maqedonase në kuadrin e projektit të administrimit të liqenit të Ohrit”.....	19
Vendim i K.M nr.94, datë 4.2.1998	Për sigurimin e informacionit në tregun e punës.....	20

Vendim i K.M nr.98, datë 4.2.1998	Për shfuqizimin e vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.153, datë 26.3.1997 dhe nr.200, datë 2.5.1997, si dhe disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.360, datë 10.7.1995.....	21
Vendim i K.M nr.111, datë 19.2.1998	Për krijimin dhe funksionimin e shërbimit të luftës kundër akteve terroriste dhe trafikut të armëve.....	21
Vendim i K.M nr.112, datë 19.2.1998	Për krijimin dhe funksionimin e shërbimit të luftës kundër drogës.....	22
Vendim i K.M nr.119, datë 16.2.1998	Për kalimin kapital pa pagesë të ndërtesës 4-katëshe në rrugën e Elbasanit Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve	23
Vendim i K.M nr.126, datë 24.2.1998	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.516, datë 24.11.1997 “Për ndryshimin e çmimit të nënprodukteve të naftës dhe të diferencave të çmimit të karburanteve të importit”.....	23
Vendim i K.M nr.129, datë 16.2.1998	Për krijimin dhe funksionimin e këshillit administrative të prefekturës.....	24
Vendim i K.M nr.131, datë 26.2.1998	Për hartimin e projektit paraprak “Për regjistrimin e përgjithshëm civil të popullsisë në Republikën e Shqipërisë”.....	25
Vendim i K.M nr.134, datë 26.2.1998	Për përbërjen e Komisionit Qeveritar të Tokës.....	26
Vendim i K.M nr.135, 26.2.1998	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.590, datë 9.9.1996 “Për miratimin dhe zbatimin e programit kombëtar të bashkëpunimit në Komisionin Evropian për vitin 1996”.....	27
Vendim i K.M nr.143, datë 26.2.1998	Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.549, datë 26.8.1996 “Për caktimin e tarifave të shërbimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.....	27
Vendim i K.M nr.144, datë 26.2.1998	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.527, datë 1.11.1993 “Për caktimin e çmimeve në sistemin e shërbimit shëndetësor”.....	28
Vendim i K.M nr.146, datë 26.2.1998	Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve	29

Vendim i K.M nr.157, datë 26.2.1998	Për fillimin e punës së zyrës s regjistrimit të pasurisë së paluajtshme në disa rrethe.....	30
Vendim i K.M nr.169, datë 6.3.1998	Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.131, datë 26.2.1998 “Për hartimin e projektit paraprak për regjistrimin e përgjithshëm civil të popullsisë në Republikën e Shqipërisë”.....	30
Vendim i K.M nr.175, datë 6.3.1998	Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.563, datë 9.10.1995 “Për aplikimin e punëve publike”, ndryshuar me vendimet nr.179, datë 18.3.1996 dhe nr.857, datë 16.12.1996.....	31

V E N D I M
Nr. 5, datë 5.1.1998

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.197, DATË 18.3.1996 “PËR RRJETIN E INSTITUCIONEVE SHKENCORE SHTETËRORE”

Me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.197, datë 18.3.1996 “Për rrjetin e institucioneve shkencore shtetërore”, në lidhjen I të hiqet Instituti Energjitik (IE) - Tiranë.
 2. Instituti Energjitik (IE) Tiranë transformohet si njësi studimore dhe projektuese brenda strukturave të sh.a. KESH (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare).
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 25, datë 5.1.1998

PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMIT TË STREHIMIT TË 24 FAMILJEVE TË FSHATRAVE QË PËRMBYTEN NGA UJËMBLEDHËSI I BOVILLËS, TË CILAT JANË PARASHIKUAR TË SISTEMOHEN NË QYTETIN E TIRANËS

Me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dhe me kërkesën e komunës së Zall Bastarit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Komunës së Zall Bastarit i miratohet fondi prej 32.138 mijë lekësh për kryerjen e pagesave të 24 familjeve të fshatrave që përmbysten nga ujëmbledhësi i Bovillës, sipas listës që i bashkëngjitet këtij vendimi, për blerjen nga ana e tyre të banesave në qytetin e Tiranës.
Kryerja e pagesave të bëhet pas lëshimit të një deklarate nga të gjithë pjesëtarët madhorë të këtyre familjeve, me të cilën të deklarojnë se nuk kanë kundërshtim me kompensimin dhe se e konsiderojnë të zgjidhur çështjen e strehimit të tyre.
Largimi i këtyre familjeve të bëhet 20 ditë pas kryerjes së pagesës.
 2. Fondet e mësipërme përballohen nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, nga fondet e vitit 1997 të veprës “Ujëmbledhësi i Bovillës”.
 3. Familjet që trajtohen me këtë vendim, përjashtohen nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 317, datë 19.5.1995 “Për sistemimin me tokë bujqësore dhe truall ndërtimi të fshatrave Zallmner, Bulqesh dhe Brurëz”.
 4. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Rrethit të Tiranës, Bashkia e Tiranës dhe komuna e Zall Bastarit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LISTA E KRYEFAMILJARËVE PËR 24 FAMILJET QË JANË PARASHIKUAR TË
SISTEMOHEN NË QYTETIN E TIRANËS NGA FSHATRA TË QË PËRMBYTEN NGA
UJËMBLEDHËSI I BOVILLËS

Për fshatin Zall-Mner

1	Xhevahir Lushi	2	1+1	1.210
2	Avdi Gega	5	3+1	1.758
3	Agim Tafa	2	1+1	1.210
4	Agim Lami	3	1+1	1.210
5	Lulzim Lila	3	1+1	1.210
6	Agron Lami	2	1+1	1.210
7	Ismail Lami	4	3+1	1.758
8	Bajram Hyseni	3	1+1	1.210
9	Khavit Ademi	6	3+1	1.758
10	Hasan Gega	4	2+1	1.512
11	Selim Abazi	5	2+1	1.512
12	Asim Ademi	2	1+1	1.210
			Shuma	a:16.764

Për fshatin Bulcesh

1	Ibrahim Cali	3	1+1	1.210
2	Hava Cali	2	1+1	1.210
3	Murat Cali	6	3+1	1.758
4	Astrit Sala	2	1+1	1.210
5	Islam Loka	2	1.+1	1.210
6	Haxhi Vogli	3	1+1	1.210
7	Ismail Muça	2	1+1	1.210
8	Qazim Hoxha	2	1+1	1.210
9	Pëllumb Popshini	2	1+1	1.210
10	Haxhie Dajti	2	1+1	1.210
11	Nazmi Koçi	5	2+1	1.512
12	Bihane Bruzi	1	1+1	1.210
			Shuma b:15.370 b	Shuma
				a+b=32.134

Shënim: Këto familje janë dakord për të marrë lekët në dorë, sipas kushteve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave për Entin Kombëtar të Banesave, dhe lejet t'u jepen brenda vitit 1997, për blerjen e shtëpive, dërguar nga komuna Zall-Bastar me shkresën nr. 205, datë 10.7.1997, nga komuna Zall-Bastar, Tiranë.

V E N D I M

Nr. 34, datë 17.1.1998

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.355, DATË 13.5.1996 “PËR KRYERJEN E REGJISTRIMIT TË PËRGJITHSHËM TË NJËSIVE EKONOMIKE BUJQËSORE”

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.7687, datë 16.3.1993 “Për statistikën”, me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe të Institutit të Statistikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.355, datë 13.5.1996, fjalja e dytë e pikës 1 ndryshohet si vijon:

“Regjistrimi i njësive ekonomike bujqësore do të fillojë në muajin qershor të vitit 1998”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 36, datë 17.1.1998

PËR CAKTIMIN E KUFIRIT MINIMAL TË REGJISTRIMIT PËR TVSH-NË

Në mbështetje të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Kufiri minimal për TVSH-në është 5 milionë lekë.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 42, datë 17.1.1998

PËR MIRATIMIN E STATUSIT TË SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT

Në mbështetje të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 "Për nxitjen e punësimit", me propozimin e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.
 2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas dhe Ministria e Financave.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

STATUTI I SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT

KREU I
KRIJIMI DHE VENDI

Neni 1

Shërbimi Kombëtar i Punësimit (më poshtë SHKP) është institucion shtetëror qendror. Ai funksionon nëpërmjet zyrave dhe agjencive lokale të punësimit, si dhe qendrave të formimit profesional.

KREU II
QËLLIMI DHE VEPRIMTARIA

Neni 2

SHKP kryen veprimtari që synojnë:
(i) përmbushjen e së drejtës të gjithë shtetasve banues në Shqipëri për t'u trajtuar me shërbime dhe për t'u mbështetur financiarisht në përpjekjet e tyre për gjetjen e një pune fitimprurëse të

përshtatshme për cilësitë individuale dhe aftësitë profesionale;

(ii) zbatimin dhe administrimin efikas të programeve dhe projekteve shtetërore, për të cilat ngarkohet me akte të posaçme ligjore a nënligjore;

(iii) zhvillimin në përgjithësi të fuqisë punëtore të vendit nëpërmjet investimeve për rritjen e aftësisë punësuese dhe vetëpunësuese, të fleksibilitetit, lëvizshmërisë, aftësisë konkurruese etj.

Neni 3

Veprimtaria e SHKP përfshin, por nuk kufizohet në:

(i) shërbime të ndërmjetësimit në punë për të papunët që kërkojnë punë, të punësuarit që kërkojnë të ndryshojnë punë, personat me paaftësi të ndryshme (më poshtë bashkërisht (“punëkërkuesit” dhe punëdhënësit);

(ii) shërbime të këshillimit profesional dhe të aftësimit për punësim a vetëpunësim për punëkërkuesit;

(iii) shërbimin e pagesës së papunësisë për individët që e përfitojnë atë;

(iv) subvencionimin e punëdhënësve që krijojnë vende të reja pune ose që punësojnë të rinj të sapodiplomuar;

(v) bashkëpunimin me pushtetin lokal për organizimin e punëve publike dhe përfshin në to të papunë që kërkojnë punë;

(vi) nxitjen e punëdhënësve që punësojnë persona me paaftësi;

(vii) formimin dhe riformimin profesional për punëkërkuesit dhe për të rinjtë në intervalin ndërmjet shkollës së mesme dhe të lartë;

(viii) kreditimin e punëdhënësve që ofrojnë trajnim dhe ritrajnim për të punësuarit e tyre;

(ix) mbështetje financiare të të papunëve që pranojnë të ndjekin kurset e trajnimit që u ofrohen;

(x) zbatimin dhe administrimin e programeve dhe projekteve që i ngarkohen me akte të posaçme ligjore dhe nënligjore;

(xi) zbatimin e marrëveshjeve a pjesëve të marrëveshjeve ndërkombëtare, për të cilat ngarkohet;

(xii) shërbimet kundrejt pagesës dhe dhënies me qira të mjeteve që zotëron, individëve ose organizmave që kryejnë veprimtari të ngjashme apo bashkëpunojnë me SHKP-në;

(xiii) investimin e fondit rezervë për përfitimin e të ardhurave për fondin kombëtar të punësimit;

(xiv) grumbullimin, regjistrimin raportimin dhe përdorimin e informacionit për fuqinë punëtore në tërësi, papunësinë, veprimtaritë dhe ndërmarrjet punëdhënëse, individët ose grupet që kërkojnë shërbime etj.

Neni 4

Zbatimi i veprimtarive, të përmendura në nenin 3 të këtij statuti, bazohet në ligjin nr.7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, në aktet nënligjore në bazë dhe për zbatim të tij, si dhe në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të SHKP-së.

KREU III

FINANCIMI, BUXHETI, KONTABILITETI, BILANCI DHE RAPORTI VJETOR

Neni 5

SHKP-ja financohet dhe administron në mënyrë të pavarur fondin kombëtar të punësimit (FKP). Të ardhurat dhe shpenzimet e FKP-së rregullohen me dispozitat e ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, statutin e fondit, rregulloren financiare të SHKP-së dhe aktet e tjera të posaçme ligjore a nënligjore.

Neni 6

Fondi garantohet nga buxheti i shtetit dhe shpenzohet në përputhje me buxhetin vjetor të SHKP-së.

Neni 7

Investimet vjetore për krijimin e kapaciteteve dhe zhvillimin afatgjatë të SHKP-së përfshihen në shpenzimet administrative të SHKP-së, të cilat nuk i kalojnë 10 për qind të buxhetit vjetor të shpenzimeve SHKP.

Neni 8

SHKP merr masa për krijimin dhe mbajtjen e një fondi rezervë për mbulimin e shpenzimeve për pagesën e papunësisë për një periudhë jo më pak se tremujore. Procedurat e hollësishme për krijimin, administrimin dhe investimin e fondit rezervë përcaktohen në statutin e fondit kombëtar të punësimit dhe në rregulloren financiare të SHKP-së.

Neni 9

SHKP-ja mban regjistrat dhe librat financiarë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, statutin e FKP-së dhe rregulloren financiare të SHKP-së. Vit financiar i SHKP-së është viti kalendarik, 1 janar deri në 31 dhjetor.

Neni 10

Në fund të çdo viti financiar SHKP-ja bën bilancin, të cilin e përfshin në raportin vjetor të SHKP-së. Raporti vjetor bëhet publik menjëherë pas miratimit të tij.

KREU IV ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHKP-SË

Neni 11

SHKP-ja përbëhet nga struktura që kryejnë funksione drejtuese, ekzekutive dhe shërbime. Drejtimi dhe ekzekutimi i veprimtarisë së SHKP-së kryhet nga këshilli administrativ tripalësh (më poshtë këshilli) dhe drejtori i përgjithshëm. Drejtorja e përgjithshme kryen veprimtari tekniko-administrative. Shërbimet realizohen nëpërmjet zyrave dhe agjencive lokale të punësimit, klubeve të punës, qendrave të formimit profesional, klubeve të biznesit dhe strukturave të tjera që krijohen e mbahen në funksion të arritjes së qëllimit të veprimtarisë së SHKP-së dhe FKP-së. Strukturat e shërbimeve janë pjesë e administratës së SHKP-së. SHKP-ja është plotësisht përgjegjëse për vendimet dhe veprimet e tyre dhe të personelit.

Neni 12

Këshilli është organi më i lartë vendimmarrës i SHKP-së. Ai kryesohet nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas dhe përbëhet nga 13 anëtarë, të cilët janë përfaqësues të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Administratës së Përgjithshme të Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale, tre anëtarë nga organizatat më të përfaqësuara të punëmarrësve në Këshillin Kombëtar të Punës dhe tre anëtarë nga punëdhënësit më të përfaqësuar. Emërtimi i anëtarëve të këshillit është i vlefshëm për një vit kalendarik. Shpërblimi për pjesëmarrjen në mbledhjet e këshillit vendoset nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 13

Këshilli mbledhet jo më pak se gjashtë herë në vit. Mbledhja e këshillit thirret nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas, Drejtori i Përgjithshëm i SHKP-së ose një e treta e anëtarëve të tij dhe drejtohet nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas. Mbledhja është e vlefshme kur në të janë të pranishëm më shumë se tre të katërtat e anëtarëve të këshillit. Për mbledhjen mbahet procesverbal i rregullt dhe vendimet nënshkruhen nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas.

Neni 14

Këshilli ka këto kompetenca:

- (i) shqyrton projektet e akteve ligjore a nënligjore që do të propozohen në lidhje me veprimtarinë e SHKP-së dhe zbatimin e legjislacionit të punësimit, punës dhe formimit profesional, si dhe rregullore të tjera për veprimtarinë e SHKP;
- (ii) miraton rregulloren e organizimit e të funksionimit dhe rregulloren financiare;
- (iii) miraton bilancin, raportin vjetor dhe projektbuxhetin për vitin në vazhdim;
- (iv) vendos për investimet e fondeve;
- (v) vendos për kontratat dhe marrëveshjet e SHKP-së;
- (vi) krijon struktura organizative sipas nevojave të veprimtarisë së SHKP-së.

Neni 15

Drejtori i Përgjithshëm është autoriteti më i lartë ekzekutiv i SHKP-së. Ai emërohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas.

Drejtori i Përgjithshëm shkarkohet kur gjatë ushtrimit të detyrës dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë me heqje lirie, ose kur është në pamundësi fizike a mendore për të kryer funksionet e ngarkuara.

Neni 16

Drejtori i Përgjithshëm ka këto kompetenca:

- (I) drejton veprimtarinë e SHKP-së;
- (II) paraqet në këshill rregulloren e organizimit e të funksionimit, rregulloren financiare dhe akte të tjera që rregullojnë veprimtari të ndryshme të SHKP-së;
- (III) nxjerr rregullore të brendshme;
- (IV) me miratim të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas, emëron drejtorët e drejtorive në SHKP dhe ato të nivelit lokale.
- (V) emëron personel të niveleve të tjera të SHKP-së.

Neni 17

Drejtorja e Përgjithshme e SHKP-së organizohet në drejtori dhe sektorë. Ajo kryen zbatimin, instruktimin, përgatitjen e personelit dhe kontrollin e detyrave që duhet të zgjidhin zyrat dhe agjencitë lokale të punësimit, qendrat e formimit profesional dhe institucionet lokale në vartësi të SHKP-së. Drejtorja e Përgjithshme administron llogaritë qendrore të FKP-së dhe shpërndan instruksione për hartimin e projektbuxhetit.

Neni 18

Zyrat dhe agjencitë lokale të punësimit krijohen në SHKP dhe janë në vartësi të tij për zbatimin e detyrave në territorin, në të cilin ato ushtrojnë veprimtarinë. Zyra lokale e punësimit drejtohet nga drejtori i kësaj zyre, i cili e ushtron funksionin e tij në konsultim me këshillin lokal tripalësh.

Neni 19

SHKP-ja, në vartësi nga programet që zbaton, mund të krijojë, transformojë a likuidojë struktura të ndryshme. Ndërtimi, përbërja dhe marrëdhëniet e ndërsjella të strukturave të SHKP-së përcaktohen në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të SHKP-së.

KREU V MARRËDHËNIET E SHKP-SË ME MINISTRINË

Neni 20

Ministri i Pun-sëes, Çështjeve Sociale dhe Gruas ushtron kontrollin dhe drejtimin e tij mbi veprimtarinë e SHKP me kompetencën e tij si kryetar i këshillit dhe të drejtën për të nxjerrë akte që ngarkojnë e rregullojnë veprimtari të caktuara brenda qëllimit dhe veprimtarisë të SHKP-së. SHKP-ja raporton, argumenton dhe paraqet për miratim paraprak te Ministri çdo iniciativë të re në marrëdhëniet e tij ndërkombëtare.

Neni 21

SHKP-ja është përgjegjës për raportimin në strukturat e autorizuara të ministrisë lidhur me informacionin për:

- (i) papunësinë në tërësi, strukturën, shkaqet, prirjet e saj;
- (ii) statusin, ecurinë e zbatimit, buxhetet, efikasitetin, rezultatet e veprimtarive të SHKP-së dhe programeve shtetërore të zbatuara apo në zbatim e sipër nga ai;
- (iii) gjendjen, zhvillimin dhe ndryshimet në forcën aktive të punës në vend.

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME DHE KALIMTARE

Neni 22

Këshilli i Ministrave miraton simbolin e SHKP-së.

Neni 23

SHKP-ja bashkëpunon, lidh marrëveshje dhe kryen veprimtari me organizatat joqeveritare shqiptare apo të huaja që kryejnë veprimtari të ngjashme me të.

Neni 24

SHKP-ja krijon një fond në lekë dhe në një valutë për financimin e pjesëmarrjes në seminare, kurse specializimi brenda dhe jashtë vendit, pritje dhe përcjellje delegacionesh a specialistësh të huaj.

Neni 25

Ky statut hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M **Nr. 43, datë 17.1.1998**

PËR ORGANIZIMIN E PANAIREVE DHE EKSPOZITAVE TREGTARE

Me propozimin e Ministrisë së Tregtisë dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Panairet dhe ekspozitat tregtare, si dhe veprimtaritë tregtare të ngjashme me to në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, të organizohen vetëm në mjedise të specializuara e të përshtatshme.

2. Panairet dhe ekspozitat tregtare me karakter kombëtar e ndërkombëtar të organizohen në bazë të një kalendari vjetor, i cili miratohet nga Ministria e Tregtisë dhe Turizmit, pasi të ketë marrë më parë mendimin e ministrive të interesuara ose organeve të pushtetit lokal, sipas llojit të panairit a ekspozitës.

3. Shoqëritë që merren me organizimin e panaireve dhe ekspozitave pajisen paraprakisht me licencë nga Ministria e Tregtisë dhe Turizmit, e cila lëshohet në përputhje me aftësitë teknike, profesionale dhe garancitë financiare të shoqërive, sipas kriterëve të vendosura në rregulloren e Ministrit të Tregtisë dhe Turizmit.

Nuk i nënshtrohen licencimit dhomat e tregtisë dhe industrisë, të cilat veprojnë sipas ligjit nr.7804, datë 10.3.1994 “Për dhomat e tregtisë dhe industrisë”.

4. Të krijohet Qendra Kombëtare e Panaireve me seli në Tiranë, si person juridik publik jobuxhetor në vartësi të Ministrisë së Tregtisë dhe Turizmit.

Objekti kryesor i kësaj qendre është përkujdesja për përgatitjen dhe ushtrimin e veprimtarisë së panaireve dhe ekspozitave tregtare.

Statuti i Qendrës Kombëtare të Panaireve miratohet nga Ministri i Tregtisë dhe Turizmit.

5. Panairet dhe ekspozitat ndërkombëtare të një rëndësie të veçantë kulturore e politike, me propozimin e Ministrit të Tregtisë dhe Turizmit dhe me miratimin e Ministrit të Shtetit pranë Kryetarit të Këshillit të Ministrave, mund të organizohen edhe në mjedise të tjera, të përshtatshme për rëndësinë e tyre.

6. Pasuria që ka në përdorim panairi i Tiranës, si dhe buxheti i parashikuar për gjashtëmujorin e parë të vitit 1998 për panairin e Tiranës i kalojnë Qendrës Kombëtare të Panaireve.

7. Ngarkohet Ministria e Tregtisë dhe Turizmit të nxjerrë rregulloren përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

8. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 411, datë 22.8.1994 “Për krijimin e panairit të Tiranës” dhe nr.57, datë 11.9.1978 “Për miratimin e rregullores për përgatitjen e ekspozitave dhe pavioneve në panairet ndërkombëtare” shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij nga data 1 janar 1998.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M

Nr. 65, datë 30.1.1998

PËR KONTROLLIN DHE PEZULLIMIN E VEPRIMEVE FINANCIARE NGA LLOGARITË BANKARE TË PERSONAVE TË LIDHUR ME SUBJEKTET E KONTROLLIT “VEFA HOLDING” SH.P.K. “SILVA” SHPK, “KAMBERI” SH.P.K. “CENAJ & CO” SH.P.K. DHE “M.LEKA” SH.P.K.

Me propozimin Zëvendëskryetarit të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të vihet nën kontroll dhe të pezullohen, deri në përfundim të procesit të transparencës, veprimet financiare nga llogaritë bankare të personave juridikë a fizikë të lidhur me subjektet e kontrollit “Vefa Holding”, “Silva”, “Kamberi”, “Cenaj” dhe “M. Leka”.

2. Konsiderohen persona të lidhur me subjektet e kontrollit të përcaktuara sipas pikës 1 të këtij vendimi Vehbi Alimuçaj, Pëllumb Shehaj, Ferdinand Kamberi, Lefter Cenaj dhe Mustafa Leka, pjesëtarët dhe të afërmit e tjerë të familjeve të lidhur në mënyrë direkte ose indirekte me drejtimin e subjektit të kontrollit, si dhe ata persona të lidhur në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 8227, datë 30.7.1997 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë.”

3. “Deloitte & Touche”, si administratore e subjekteve të kontrollit, verifikon të gjitha llogaritë bankare të personave që rezultojnë të tillë në kuptim të pikës 2 të këtij vendimi dhe pezullon veprimet financiare të tyre. Për kontrollin financiar të llogarive bankare të personave të lidhur me ta vendos Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 73, datë 30.1.1998

PËR DISA ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJIT NR.7703, DATË 11.5.1993 “PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, SI DHE TË LIGJIT NR. 7870, DATË 13.10.1994 “PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Me propozimin e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mjedisit, Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Në zbatim të neneve 2 dhe 9 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të neneve 4 dhe 8 të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, sigurohen në mënyrë të detyrueshme:

1. Personat e punësuar sipas një kontrate pune pa afat të caktuar dhe që zgjat për më shumë se koha javore e punës, sigurohen për aftësi të përkohëshme në punë, barrë lindjeje, pensione, aksidente në punë e sëmundje profesionale, papunësi dhe në sigurimin shëndetësor.

2. Sigurohen për aksidente në punë, sëmundje profesionale dhe sigurim shëndetësor personat e punësuar sipas një kontrate pune me afat të caktuar:

- a) që zgjat për më pak kohë se koha javore e punës në një punëdhënës gjatë gjithë vitit;
- b) për kohë të pjesshme pune.

3. Personat e punësuar sipas një kontrate pune sezonale a të përkohshme, kur punojnë sipas një kontrate pune që zgjat më pak se tre muaj në vit. Këta sigurohen për paaftësi të përkohëshme, barrë lindjeje, aksidente në punë dhe sëmundje profesionale.

4. Personat e tjerë ekonomikisht aktivë, (punëdhënës dhe të vetëpunësuar), të cilët kanë ardhur nga një veprimtari ekonomike, pavarësisht nga kohëzgjatja e saj. Këta sigurohen për barrë lindjeje dhe në sigurimin shëndetësor.

5. Të vetëpunësuarit në bujqësi të aftë për punë, që kanë mbushur moshën 16 vjeç dhe që nuk janë të siguruar nga punësimi në sektorë të tjerë. Këta sigurohen në mënyrë të detyrueshme për barrë lindjeje, për pensione dhe në sigurimin shëndetësor.

6. Personat me të ardhura të rregullta nga pronësia, sipas deklarimit në zyrën e tatimeve. Këta bëjnë vetëm sigurimin shëndetësor.

II. Në zbatim të neneve 2, 32, 36, 48 dhe 54 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, niveli bazë për vitin 1998 është 4000 lekë.

Në zbatim të nenit 96 të po këtij ligji, kur personat nuk i plotësojnë kushtet për përfitimin e masës të pensionit të përcaktuar nga paragrafi i parë i këtij neni, niveli bazë për vitin 1998 është 1050 lekë në muaj.

III. Në zbatim të neneve 9,10, 14 dhe 90 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” dhe në zbatim të neneve 8, 9, 10, 11 dhe 12 të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”.

1. Masa e kontributeve minimale mujore për të gjitha degët e sigurimit për punëmarrësit dhe për efekt të sigurimit vullnetar të personave të tjerë është 2772 lekë.

2. Punëdhënësi bën sigurimin e personave të punësuar nga dita që punëmarrësi fillon punën me pagesë, duke u mbështetur në një kontratë pune, dhe e vazhdon atë gjatë gjithë kohës që punëmarrësi është në marrëdhënie pune. Për këta të punësuar punëdhënësi derdh kontribut të detyrueshëm në masën 49.5 për qind të listëpagesave mujore në kufijtë e pagës jo më të ulët se 6040 lekë dhe maksimale 18120 lekë.

3. Punëdhënësit për veten e tyre dhe të vetëpunësuarit (duke përjashtuar të vetëpunësuarit në bujqësi) derdhen kontribut të detyrueshëm në masën 41.5 për qind të pagës mujore minimale 6040 lekë, që i përgjigjet kontributit mujor minimal 2500.

4. Për punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit periudha e detyrimit ndaj sigurimeve shoqërore nis ditën kur personi ka filluar ligjërisht veprimtarinë ekonomike dhe mbaron ditën kur përfundon ligjërisht kjo veprimtari. Ndërprerjet e veprimtarisë gjatë vitit kalendarik vërtetohen nga organet përkatëse. Personat juridikë e fizikë privatë nuk u jepet e drejta e fillimit të veprimtarisë private nga degët e tatim-taksave, në qoftë se personi fizik a juridik nuk paraqet aktin e regjistrimit në organet e sigurimeve shoqërore, si dhe nuk i jepet leja e vazhdimit të veprimtarisë për vitin, në qoftë se nuk paraqet vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore.

5. Personat e tjerë (mbi 16 vjeç) me të ardhura të rregullta nga pronësia (dhe që nuk kanë ndonjë punësim tjetër) paguajnë kontribut të sigurimit shëndetësor në masën 7 për qind të pagës mujore minimale 6040 lekë (që i përgjigjet kontributit mujor minimal 423 lekë).

6. Të vetëpunësuarit në bujqësi derdhen kontributin vjetor në masën 15 për qind të të ardhurave fikse vjetore 10800 lekë, e barabartë me 1620 lekë. Për rrethet Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë e Tropojë masa e kontributit vjetor do të jetë 9 për qind e barabartë me 972 lekë.

Të vetëpunësuarit në bujqësi kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore i paguajnë individualisht.

Përjashtohen nga siguri i detyrueshëm shoqëror familjet e të vetëpunësuarve në bujqësi, që përfitojnë nga ligji nr. 7710, datë 18.5.1995 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”. Periudhat gjatë të cilave përfitohet nga ky ligj nuk njihen periudha siguri.

Të vetëpunësuarit paguajnë veçan kontributet e detyrueshme për sigurimet shëndetësore, pavarësisht nga pagesa e kontributeve për sigurimin shoqëror, në masën:

-në zonën fushore 5 për qind të pagës minimale, e barabartë me 45 lekë në muaj;

-në zonën kodrinore-malore 3 për qind e pagës minimale, e barabartë me 27 lekë në muaj.

Ndarja në zona është sipas përcaktimit të mësipërm për pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore.

IV. Në zbatim të neneve 13 dhe 15 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 8, 9 dhe 11 të ligjit 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, punëdhënësi detyrohet të paguajë dhe të paraqesë çdo muaj në agjencitë e sigurimeve shoqërore të rrethit listën emërore, pagën mujore, pagën mbi të cilën është derdhur kontributi dhe masën e kontributit të derdhur për çdo të punësuar.

Të vetëpunësuarit, në kushte të veçanta të pranueshme, mund të paguajnë kontributin një herë në 3 muaj, siç parashikohet në rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

V. Në zbatim të nenit 59 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 10 të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ardhurat, mbi të cilat llogariten dhe paguhen kontributet janë:

1. paga që jep punëdhënësi sipas një kontrate pune;

2. të ardhurat nga një punë e dytë ose një punë tjetër, të cilat raportohen te punëdhënësi kryesor dhe kontributet që rrjedhin prej tyre, nuk duhet të tejkalojnë pagën maksimale të siguruar;

3. të ardhurat nga vetëpunësimi, pavarësisht nëse personi është i regjistruar; Në rastet kur

personi është i punësuar te një punëdhënës dhe njëkohësisht është i vetëpunësuar, kontributet do të paguheshin si i punësuar dhe për diferencë si i vetëpunësuar deri në pagën maksimale të sigurimit si i punësuar.

Nuk quhen të ardhura nga veprimtaria ekonomike dhe nuk u nënshtrohen kontribucioneve përfitimet nga ligji i sigurimeve shoqërore, kompensimet nga rritja e çmimeve, dhuratat, të ardhurat nga detyrimi për ushqim sipas Kodit Civil dhe shpërblimi nga fondi i veçantë.

Rregullat për përcaktimin e pagesës për efekt të ligjit “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” vendosen me udhëzim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

VI. Marrëdhëniet administrative e financiare ndërmjet Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mjedisit, Institutit të Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor, bankave, ndërmarrjes së postave dhe Sekretariatit Shtetëror për Pushtetin Lokal do të rregullohen me akte ligjore e nënligjore të përbashkëta.

VII. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas, Ministria e Shëndetësisë dhe Mjedisit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Instituti i Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor të përgatisin udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi dhe t’ia paraqesin atë Këshillit të Ministrave për miratim, brenda muajit janar të vitit 1998.

Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 23.1.1995, dhe nr. 20, datë 13.1.1997 shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 shkurt 1998.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M

Nr. 76, datë 30.1.1998

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË GRUPIT “COMMODITY AID-22 MILIARDË LIRETA”

Me propozimin e Ministrisë së Tregtisë dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit si përgjegjëse për zbatimin e fondeve të grupit “Commodity Aid 22-miliardë lireta” dhe të marrë masat e duhura për përdorimin në kohë të tyre.

2. Praktika e zhvilluar deri tani nga ish-Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë i kalon sipas rregullave përkatëse për kompetencë Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

3. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.225, datë 15.5.1995 “Për përdorimin e fondeve të grupit Commodity AID” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M

Nr. 82, datë 4.2.1998

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 356, DATË

**10.9.1997 "PËR EMËRIMIN E GUVERNATORËVE DHE ZËVENDËSGUVERNATORËVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PRANË INSTITUCIONEVE NDËRKOMBËTARE
FINANCIARE E TË ZHVILLIMIT"**

Me propozimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 356, datë 10.9.1997 "Për emërimin e guvernatorëve dhe zëvendësguvernatorëve të Republikës së Shqipërisë pranë institucioneve ndërkombëtare financiare dhe të zhvillimit", pas pikës 12 shtohen dy pika me këtë përmbajtje:

"13. Zëvendësministri i Financave të emërohet guvernator i Republikës së Shqipërisë pranë Bankës së Tregtisë dhe Zhvillimit të Detit të Zi.

"14. Drejtori i Drejtorisë së Mbikëqyrjes në Ministrinë e Financave të emërohet Zëvendësguvernator i Republikës së Shqipërisë pranë Bankës së Tregtisë dhe Zhvillimit të Detit të Zi".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI
Fatos Nano**

**V E N D I M
Nr. 83, datë 4.2.1998**

**PËR CAKTIMIN E EKSPERTËVE KONTABËL TË PAVARUR DHE TË
ADMINISTRATORËVE NË SHOQËRINË "GJALLICA SH.P.K.**

Me propozimin e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në shoqërinë "Gjallica" sh.p.k. ndaj së cilës organi i prokurorisë ka filluar çështjen penale, caktohen ekspertë kontabël të pavarur për një kohë prej 6 muajsh, deri në mbyllje të procesit të gjykimit.

2. Për objektet në veprimtari prodhimi dhe për ato që mund të riaktivizohen, vendosen administratorë lokalë si në:

- klinikën stomatologjike "Dentalba" në Tiranë;
- fabrikën e qumështit në Libohovë;
- fabrikën e kripës në Vlorë;
- fabrikën e tullave në Vlorë.

3. Numri i ekspertëve kontabël të pavarur për këtë shoqëri të jetë 6 veta dhe i administratorëve lokalë 4 veta, sipas listës që i bashkëngjitet këtij vendimi.

4. I rekomandohet prokurorisë, që për sa kohë vazhdon procesi i hetimit dhe i gjykimit, mund të thërresë për zbërthimin e materialit të ekspertizës, specialistë të Kontrollit të Lartë të Shtetit që kanë punuar për përgatitjen e tij.

5. Paga bazë mujore e ekspertëve kontabël të pavarur dhe e administratorëve që do të vendosen në objektet e shoqërisë "Gjallica", sh.p.k. të jetë 30-35 mijë lekë në muaj dhe caktohet nga vetë organi i prokurorisë.

6. Prokurorisë së Përgjithshme, për të përballuar pagat e ekspertëve kontabël të pavarur dhe të administratorëve, në planin e vitit 1998 i shtohen 2.5 milionë lekë nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**LISTA EMËRORE E PERSONAVE QË DO TË CAKTOHEN SI EKSPTERTË KONTABËL TË
PAVARUR DHE ADMINISTRATORË NË SHOQËRINË "GJALLICA" SH.P.K.**

Personat që mund të vendosen si ekspertë kontabël:

1. Arben Abazi
2. Liliana Enesi
3. Astrit Qerimi
4. Sadedin Zeqo
5. Astrit Balla
6. Shkëlqim Balla
- 7.
- 8.
- 9.

Personat që mund të vendosen si administratorë:

1. Burbuqe YmeriKlinika "Dentalba", Tiranë
2. Luiza Bejtja (Dinaj)Fabrika e Tullave, Tiranë
- Fabrika e Qumështit, Libohovë
- Fabrika e Kripës, Vlorë
- 4.
- 5.
- 6.

V E N D I M
Nr. 91, datë 30.1.1998

**PËR DISA NDRYSHIME NË PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË PYJORE DHE
POLICISË SË NDËRTIMIT**

Me propozimin e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas, mbështetur në fondet e caktuara në Buxhetin e Shtetit për vitin 1998, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.185, datë 16.4.1993 "Për pagat dhe shtesat mbi pagë të ushtarakëve të shërbimit pyjor", bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 2, niveli më i ulët i pagës bëhet 5 800 në muaj dhe niveli më i lartë (drejtor drejtori, kryetar dege) bëhet 14 900 lekë në muaj. Kompensimi për vete dhe për personat në ngarkim që ka përfituar çdo ushtarak, bashkohet me pagën bazë mujore.

2. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 238, datë 16.4.1996 "Për organizimin dhe strukturën e policisë së ndërtimit", bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 2, niveli më i ulët i pagës bëhet 5800 në muaj dhe niveli më i lartë (drejtor drejtorie, kryetar dege) bëhet 14 900 lekë në muaj. Kompensimi për vete dhe për personat në ngarkim që ka përfituar çdo i punësuar, është bashkuar me pagën bazë mujore.

3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi përballohen nga fondet e Buxhetit të Shtetit për vitin 1998.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 shkurt 1998.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 93, datë 4.2.1998

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 552, DATË 26.8.1996 “PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPITIMIT NDËRMJET QEVERISË SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË MAQEDONASE NË KUADRIN E PROJEKTIT TË ADMINISTRIMIT TË LIQENIT TË OHRIT”

Me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshilit të Ministrave nr. 552, datë 26.8.1996, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet si vijon: “Miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Maqedonase për projektin e ruajtjes së liqenit të Ohrit, të mbështetur nga Banka Botërore dhe të financuar nga Global Environmental Facility (GEF)”.

b) Pika 3 ndryshohet si vijon:

“Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mjedisit, Ministri i Shtetit për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Ekonomik dhe Komiteti i Mbrojtjes së Mjedisit për negocimin e projektit “Për ruajtjen e liqenit të Ohrit”, të financuar nga Fondi Botëror për Mjedisin Global Environmental Facility(GEF)”.

c) Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje :

“Ngarkohet Komiteti i Mbrojtjes së Mjedisit për zbatimin e këtij projekti”.

Ky vendim në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 94, datë 4.2.1998

PËR SIGURIMIN E INFORMACIONIT NË TREGUN E PUNËS

Në mbështetje të ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, me propozimin e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas, nëpërmjet Drejtorisë së Statistikës dhe Informacionit, mbledh dhe përpunon informacion statistikor në fushën e tregut të punës e të mbrojtjes sociale dhe e përdor atë për të bërë analizën dhe parashikimin e tregut të punës, si dhe për të hartuar e orientuar drejt politikave të saj sociale.

2. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas, për të mbledhur këtë informacion, bashkëpunon me ministrinë e tjera, Sekretariatën Shtetërore për Pushtetin Lokal, Institutin e Statistikës, institucionet e tjera qendrore, si dhe me Shërbimin Kombëtar të Punësimit, Administratën e Përgjithshme të Çështjeve Sociale, Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe Inspektoratën Shtetërore të Punës.

Për këto detyrohen:

-Të gjitha ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore, si dhe organet e pushtetit lokal, sipas ligjit nr. 7687, datë 16.3.1993 "Për statistikën", të japin informacion në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas për treguesit statistikorë të tregut të punës dhe prirjet e zhvillimeve të këtij tregu për fushat që ato mbulojnë.

-Të gjitha fondacionet vendase ose të huaja, të cilat financojnë projekte vetëpunësuese, të japin informacion në zyrën e punësimit për numrin e të punësuarve që përfitojnë vende pune nëpërmjet këtyre projekteve.

-Të gjitha subjektet private të japin informacion në zyrën e punësimit për numrin e të punësuarve dhe vendet e lira të punës. Zyrat e punësimit detyrohen të mbajnë në fshehtësi informacionin e marrë nga çdo subjekt privat dhe ta përdorin atë vetëm në formë të përmbledhur, pa zbuluar të dhënat e biznesit të punëdhënësit.

-Të vendoset bashkëpunimi dhe bashkëveprimi ndërmjet organeve të nivelit lokal (zyrat e punës, seksionet e ndihmës ekonomike në bashki e komuna, zyrat e statistikës në rrethe, degët e sigurimeve shoqërore), të cilat marrin dhe përdorin informacion për tregun e punës, për shkëmbimin e këtij informacioni.

3. Informacioni për tregun e punës të jepet periodikisht gjatë vitit dhe domosdoshmërisht në fund të çdo tremujori. Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas përcakton periodicitetin dhe afatet e dhënies së këtij informacioni.

4. Parashikimi i tregut të punës kryhet në nivel lokal dhe atë kombëtar për:

-përshkrimin e gjendjes së tregut të punës në rrethana konkrete;

-parashikimin e zhvillimeve të tregut të punës për periudhat pasardhëse sipas tabelave të bashkëngjitura. Miratimi i tabelave dhe ndryshimet e tyre janë kompetencë e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas.

5. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas u dërgon ministrive, institucioneve të tjera qendrore dhe organeve të pushtetit lokal informacion për parashikimin e tregut të punës në shkallë kombëtare.

6. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas të nxjerrë udhëzimet përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

7. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 296, datë 5.6.1995 "Për parashikimin afatshkurtër të tregut të punës" shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M **Nr. 98, datë 4.2.1998**

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.153, DATË 26.3.1997 DHE NR. 200, DATË 2.5.1997, SI DHE DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.360 DATË 10.7.1995

Me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.153, datë 26.3.1997 "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 360, datë 10.7.1995 "Për regjimin e eksport-importit nga dhe në Republikën e Shqipërisë"" shfuqizohet.

2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 200, datë 2.5.1997 "Për disa masa për forcimin e ruajtjes së mallrave, paJisjeve e objekteve ushtarake dhe shtetërore" shfuqizohet.

3. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 360, datë 10.7.1995, pika 2 ndryshohet si vijon:

"Eksporti i mallrave nga Republika e Shqipërisë është i lirë me përjashtim të mallrave të

mëposhtme, eksporti i të cilave është i ndaluar:

72.04. Skrape të gizës dhe çelikut (me përjashtim të skrapeve të çelikeve të pandryshkshëm dhe mbetjeve të gizës nga kovat e furrëllartës).

74.01 deri 74.19. Bakri dhe artikujt prej bakri (me përjashtim të skorjeve të bakrit, bakrit elektrolitik dhe prodhimeve artistike të imta prej bakri jo të derdhur)".

4. Aktiviteti i grumbullimit dhe i përpunimit të mbetjeve dhe skrapeve metalike bëhet me leje nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit që, brenda datës 10 shkurt 1998, të nxjerrin udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M

Nr. 111, datë 19.2.1998

PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT TË LUFTËS KUNDËR AKTEVE TERRORISTE DHE TRAFIKUT TË ARMËVE

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.7504, datë 30.7.1991 "Për policinë e rendit", me propozimin e Ministrisë së Brendshme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e Shërbimit të luftës kundër akteve terroriste dhe trafikut të armëve, si shërbim i specializuar, gjurmues-hetimor i policisë kriminale, për parandalimin, zbulimin, dokumentimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të akteve terroriste dhe trafikut të armëve.

2. Shërbimi i luftës kundër akteve terroriste dhe trafikut të armëve organizohet në:

a) sektorin e luftës kundër akteve terroriste dhe trafikut të armëve në përbërje të Drejtorisë së Policisë Kriminale;

b) zyrat rajonale të luftës kundër akteve terroriste dhe trafikut të armëve pranë drejtorive të policisë në shkallë prefekturë.

3. Sektori i luftës kundër akteve terroriste dhe trafikut të armëve në Drejtorinë e Policisë Kriminale ka në përbërje të tij zyrën e luftës kundër akteve terroriste dhe zyrën e luftës kundër trafikut të armëve.

Detyrat funksionale, kompetencat e sektorit dhe të zyrave rajonale përcaktohen me rregullore të veçantë të Ministrit të Brendshëm.

4. Zyrat rajonale të luftës kundër akteve terroriste dhe trafikut të armëve janë në vartësi të drejtpërdrejtë të sektorit "S.K.A.T.E.T" në Drejtorinë e Policisë Kriminale dhe funksionojnë në përbërje të sektorit të policisë kriminale në drejtorinë e policisë në shkallë prefekturë.

5. Ministrinë dhe strukturat e tjera qendrore të administratës shtetërore që lidhen me problemet e luftës kundër akteve terroriste dhe trafikut të armëve, në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, të përcaktojnë me akte të përbashkëta format dhe mënyrat e bashkëveprimit të tyre.

6. Ngarkohet Ministri i Brendshëm të nxjerrë aktet përkatëse për limitin organik dhe mënyrën e funksionimit të këtij shërbimi.

7. Efektet financiare përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Brendshme për vitin 1998.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr. 112, datë 19.2.1998

PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT TË LUFTËS KUNDËR DROGËS

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.7504, datë 30.7.1991 “Për policinë e rendit”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijohet Shërbimi i luftës kundër drogës, si shërbim i përqendruar dhe i specializuar, gjurmues-hetimor i policisë kriminale për kërkimin, konstatimin, zbulimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të trafikut, prodhimit, shpërndarjes, shitjes dhe transportimit të drogës, si dhe të kultivimit të bimëve narkotike.

1. Shërbimi i luftës kundër drogës organizohet në:

-shërbim qendror i luftës kundër drogës në përbërje të Drejtorisë së Policisë Kriminale;

-zyrat rajonale të luftës kundër drogës që funksionojnë pranë drejtorive të policisë në prefektura.

3. Shërbimi qendror i luftës kundër drogës ka në përbërje të tij zyrën e luftës kundër trafikut dhe zyrën e luftës kundër kultivimit dhe prodhimit të saj. Detyrat funksionale dhe kompetencat e tyre përcaktohen me urdhër të veçantë të Ministrit të Brendshëm.

4. Zyrat rajonale të luftës kundër drogës, për funksionet që do të kryejnë në zbatim të detyrave të tyre, janë në varësi të drejtpërdrejtë të Shërbimit qendror të luftës kundër drogës në Drejtorinë e Policisë Kriminale të Ministrisë së Brendshme.

Detyrat funksionale të tyre dhe kompetencat përcaktohen me urdhër të Ministrit të Brendshëm.

5. Ministrinë dhe strukturat e tjera qendrore të administratës shtetërore që lidhen me problemet e luftës kundër drogës, në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, të përcaktojnë format dhe mënyrat e bashkëveprimit ndërmjet tyre.

6. Ngarkohet Ministria e Brendshme të nxjerrë aktet përkatëse në zbatim të këtij vendimi.

7. Efektet financiare përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Brendshme për vitin 1998.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 119, datë 16.2.1998

PËR KALIMIN KAPITAL PA PAGESË TË NDËRTESES 4-KATËSHE NË RRUGËN E ELBASANIT DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ndërtesa 4-katëshe në rrugën e Elbasanit, në Tiranë (e emërtuar “Triko me porosi”), deri tani në pronësi të Bankës Tregtare Agrare, i bëhet kalim kapital pa pagesë Drejtorisë së Përgjithshme

të Tatimeve.

2. Për zbatim të këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Banka Tregtare Agrare.

3. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 601, datë 31.12.1997 shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M

Nr. 126, datë 24.2.1998

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.516, DATË 24.11.1997 “PËR NDRYSHIMIN E ÇMIMIT TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE TË DIFERENCAVE TË ÇMIMIT TË KARBURANTEVE TË IMPORTIT

Me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 516, datë 24.11.1997 “Për ndryshimin e çmimit të nënprodukteve të naftës dhe të diferencave të çmimit të karburanteve të importit”, në pikën 1, pas paragrafit të tretë, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Për gazoilin dhe benzinën e prodhuar në vend çmimet minimale të shitjes me pakicë nuk mund të jenë më të ulëta se 15 lekë për litër nën çmimin maksimal të përcaktuar në paragrafin e parë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M

Nr. 129, datë 16.2.1998

PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT ADMINISTRATIV TË PREFEKTURËS

Në mbështetje të ligjit nr. 7608, datë 22.9.1992 “Për prefekturat”, ndryshuar me ligjin nr.8209, datë 22.4.1997, me propozimin e Sekretariatit Shtetëror për Pushtetin Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në çdo prefekturë, me vendim të prefektit, krijohen si organ këshillimor këshilli administrativ i prefekturës, i cili përbëhet nga:

- prefekti;

- sekretari i përgjithshëm i prefekturës;

kryetarët e këshillave të rretheve dhe kryetarët e bashkive në juridiksion të prefekturës;

drejtori i policisë së prefekturës;

komandantët e njësive të mëdha ushtarake në prefekturë;

shefi i qendrës së mobilizimit;
drejtorët e drejtorive të bujqësisë dhe ushqimit, të arsimit dhe shëndetit publik;
shefi i inspektoratit të mbrojtjes së mjedisit në nivel prefekturë;
kryetarët e degëve të buxhetit, thesarit të tatimtaksave dhe doganave në rrethe;
përgjegjësi i zyrave të punës dhe çështjeve sociale në rrethe;
drejtorët e policisë së ndërtimit.

Këshilli administrativ kryesohet nga prefekti.

2. Mbledhjet e keshillit administrativ të bëhen jo më pak se një herë në tre muaj, por keshilli mund të mbledhet edhe më shpesh në varësi nga problemet që dalin dhe kur një gjë e tillë gjykohet e domosdoshme.

3. Mbledhja e keshillit administrativ mund të bëhet edhe me pjesëmarrje të kufizuar, për probleme me karakter të veçantë. Në këtë rast pjesëmarrja përcaktohet nga prefekti.

Prefekti kur e çmon të arsyeshme, mund të ftojë në mbledhjet e keshillit administrativ edhe persona të tjerë të zgjedhur, ose funksionarë të pushtetit lokal e të administratës shtetërore lokale.

4. Mbledhjet e keshillit administrativ bëhen sipas kësaj procedure:

- Njoftimi për mbledhjen e keshillit administrativ bëhet jo më vonë se tri ditë përpara. Pjesëmarrësve u bëhet e ditur rendi i ditës, data dhe ora e saktë e mbledhjes. Përjashtim bëhet për mbledhjet e diktura nga problemet e ngutshme.

- Prefekti parashtron problemet, për të cilat do të diskutohet sipas rendit të ditës me shkrim dhe në raste të veçanta me gojë. Pas diskutimit të problemeve me pjesëmarrësit, prefekti nxjerr përfundime veças për zgjidhjen e çdo problemi të shtruar dhe merr vendimin përkatës.

Këshilli i Ministrave, nëpërmjet Sekretariatit Shtetëror për Pushtetin Lokal, informohet rregullisht me shkrim për përfundimet e çdo mbledhjeje të keshillit administrativ, sipas informacionit me shkrim të dërguar nga prefekti brenda tri ditëve nga dita e zhvillimit të mbledhjes.

Anëtarët e keshillit i përgjigjen prefektit për kërkesat që ai u parashtron dhe kanë të drejtë të bëjnë sugjerimet përkatëse me shkrim ose me gojë.

5. Në mbledhjet e keshillit administrativ të prefekturës shqyrtohen probleme të rëndësishme si:

- përgatitja e programit vjetor të prefekturës;

probleme të zhvillimit ekonomik-shoqëror të prefekturës;

probleme që lidhen me sigurimin e rendit e të qetësisë publike të prefekturës;

probleme të bashkërendimit të punës mes institucioneve të veçanta e të administratës shtetërore në nivel lokal, si dhe këtyre institucioneve me organet e zgjedhura të pushtetit lokal të prefekturës;

probleme që lidhen me ruajtjen dhe sigurimin e shëndetit publik dhe ruajtjen e mjedisit të prefekturës;

zbatimi i ligjeve dhe akteve nënligjore nga organet e pushtetit lokal dhe administrata e tyre;

masat që merren nga institucionet buxhetore për zbatimin e buxhetit dhe miradministrimin e burimeve ekonomikokulturore, natyrore e historike;

bashkërendimin e punës mes komandave ushtarake dhe institucioneve e organeve civile për plotësimin e detyrave në fushën e mbrojtjes, në përputhje me ligjet, vendimet e Keshillit të Mbrojtjes e të Keshillit të Ministrave;

masat mbrojtëse ndaj fatkeqësive natyrore;

zbatimi i detyrimeve të shtetasve për mobilizimin ushtarak, si dhe për çdo problem tjetër që lidhet drejtpërdrejtë me ushtrimin e kompetencave dhe detyrave që ligji i ka ngarkuar prefektit.

6. Problemet e shqyrtuara në mbledhjen e keshillit administrativ, u dërgohen organeve dhe institucioneve të interesuara për ndjekjen e tyre.

7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen prefektët.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 131, datë 26.2.1998

PËR HARTIMIN E PROJEKTIT PARAPRAK “PËR REGJISTRIMIN E PËRGJITHSHËM CIVIL TË POPULLSISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Me propozimin e Sekretariatit Shtetëror për Pushtetin Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e grupit të punës për hartimin e projektit “Për regjistrimin e përgjithshëm civil të popullsisë në Republikën e Shqipërisë” dhe përgatitjen e projektligjit për aktet e gjendjes civile.

2. Në përbërje të grupit të punës të jenë përfaqësues të këtyre institucioneve: tre nga Sekretariati Shtetëror për Pushtetin Lokal, një nga Ministria e Shtetit për Reformën Legjislative dhe marrëdhëniet me Kuvendin Popullor, një nga Ministria e Shtetit për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Ekonomik, dy nga Ministria e Drejtësisë, dy nga Ministria e Brendshme, një nga Ministria e Financave, një nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas, dy nga Komisioni Qendror i Përhershëm i Zgjedhjeve, dy nga Instituti i Statistikës, një nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, një nga Instituti i Informatikës dhe një nga Fakulteti Ekonomik (katedra e statistikës-njësia e demografisë).

Brenda datës 1.3.1998, titullarët e institucioneve të përmendura në pikën 2 të këtij vendimi të caktojnë përfaqësuesit e tyre në këtë grup pune dhe t’ia paraqesin Ministrit të Shtetit pranë Kryetarit të Këshillit të Ministrave.

3. Grupi i punës kryesohet nga Ministri i Shtetit pranë Kryetarit të Këshillit të Ministrave, i cili miraton programin e punës dhe procedurat e veprimtarisë së këtij grupi.

4. Për hartimin e projektit paraparak grupi i punës mund të angazhojë specialistë vendas a të huaj të fushave përkatëse që lidhen me elementët përbërës të projektit.

5. Shpenzimet administrative për hartimin e projektit dhe shpërblimet e anëtarëve të grupit të punës përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave në masën 5 milionë lekë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 134, datë 26.2.1998

PËR PËRBËRJEN E KOMISIONIT QEVERITAR TË TOKËS

Me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përbërja e Komisionit Qeveritar të Tokës pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit të jetë sipas lidhjes nr.1 që i bashkëngjitet këtij vendimi.

2. Komisioni si rregull mbledhet jo më pak se një herë në tre muaj.

3. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 512, datë 12.8.1996 “Për përbërjen e Komisionit Qeveritar të Tokës” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

PËRBËRJA E KOMISIONIT QEVERTAR TË TOKËS

Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit Kryetar
Zëvendësministri i Bujqësisë dhe Ushqimit Zv. kryetar
Drejtori i Drejtorisë së tokave në MBU sekretar
Kryetar i Komitetit të Mjedisit anëtar
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë anëtar
Zëvendësministri i Drejtësisë anëtar
Zëvendësministri i Punëve Publike dhe Transportit anëtar
Zëvendësprokurori i Prokurorisë së Përgjithshme anëtar
Prefekti i Prefekturës, Fieranëtar
Kryetari i Këshillit të Rrethit, Lezhë anëtar
Koordinatori për Bujqësinë dhe Ushqimin në
Kryeministri anëtar
Kryeregjistruesi i Pasurisë së Paluajtshme anëtar
Drejtori i Drejtorisë së Pushtetit Lokal anëtar
Drejtori i Drejtorisë Juridike në MBU anëtar
Drejtori i Institutit të Studimit të Tokave anëtar
Drejtori i NMP dhe SRPP anëtar
Drejtorisë së Bujqësisë Lushnjë anëtar

V E N D I M

Nr. 135, datë 26.2.1998

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 590, DATË 9.9.1996 “PËR MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E PROGRAMIT KOMBËTAR TË BASHKËPUNIMIT NË KOMISIONIN EUROPIAN PËR VITIN 1996”

Në kuadrin e bashkëpunimit me Bashkimin European për vitin 1997, me propozimin e Ministrisë së Financave dhe Ministrit të Shtetit për Zhvillimin e Bashkëpunimit Ekonomik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në marrëveshjen kuadër ndërmjet Bashkimit European dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 590, datë 9.9.1996 “Për miratimin dhe zbatimin e programit kombëtar të bashkëpunimit me Komisionin European për vitin 1996”, aneksi 2 pika 4, programi për mbështetjen e doganave nuk do të përfshihet më në sistemin e implementimit të decentralizuar, por kalon në sistemin e implementimit të centralizuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M

Nr. 143, datë 26.2.1998

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 549, DATË

**26.8.1996 “PËR CAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË ZYRAVE TË
REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME”**

Në mbështetje të ligjit nr. 7581, datë 7.7.1992 “Për çmimet dhe tarifat dhe të neneve 54 dhe 56 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 549, datë 26.8.1996, lista e tarifave të shërbimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme ndryshohet dhe zëvendësohet me listën që i bashkëngjitet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**NDRYSHIMI I TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË ZYRAVE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME**

LLOJI I SHËRBIMEVE	ISHTE BËHET	
1. Lëshimi i certifikatave të pasurisë	200	400
2. Kërkesa për regjistrimin e pronësisë të pasurisë së paluajtshme	50	200
3. Kërkesa për regjistrimin e pjesëtimit , ndarjes ose bashkimit të pasurisë së paluajtshme	100	300
4.Kërkesa për konsultim të kartelës dhe të të dhënave të tjera të pasurisë së paluajtshme	50	200
5. Kërkesa për kontroll zyrtar të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme	70	500
6. Kërkesa për lëshimin e kopjes së certifikatës së pasurisë së paluajtshme	300	300
7. Kërkesa për saktësimin e kufijve	500	1500
8. Kërkesa për përgatitjen e dokumenteve për në gjykatë, ose organ tjetër administrativ	250	500
9. Kërkesa për regjistrimin për kalim pronësie, qiraje, nënqiraje	150	1500
10. Kërkesa për regjistrim hipoteke ligjore	100	500
11. Kërkesa për regjistrim për fshirje hipoteke ligjore	100	500
12.Kërkesa për regjistrim për fshirjen e një vendimi gjykate a të një akti administrativ	150	500
13.Kërkesa për regjistrim servituti, marrëveshje kufizuese	200	600
14.Kërkesa për regjistrim fshirjen e një servituti, marrëveshjeje kufizuese	200	600
15. Regjistrimi i kërkesave për heqje dorë nga të drejtat pasurore mbi pasurinë e paluajtshme	150	200
16. Regjistrimi i kërkesave për fitimin e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme me trashëgimi	200	200
17. Kërkesa për regjistrimin e veprimeve juridike mbi pasuritë e paluajtshme nga personat fizikë dhe juridikë me banim jashtë shtetit	600	1500
18. Kërkesa për korrigjimin e gabimeve materiale në kartelë	100	200
19. Kërkesa për lëshim kopje karte, harte treguese ose pjese të saj	120	400
20. Kërkesa për fotokopje të dokumenteve të pasurive të paluajtshme për çdo faqe	10	50
21. Lëshimi vërtetimit të pronësisë	-	50

V E N D I M
Nr.144, datë 26.2.1998

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 527,
DATË 1.11.1993 “PËR CAKTIMIN E ÇMIMEVE NË SISTEMIN E SHËRBIMIT
SHËNDETSOR”**

Me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 527, datë 1.11.1993 “Për caktimin e çmimeve në sistemin e shërbimit shëndetësor”, në tarifat për shërbimin shëndetësor ambulator, në zërin e vizitave ambulatorë, pika 1 ndryshohet si vijon:

“1. Kryerja e vizitave ambulatorë në poliklinikë për specialistët e të gjitha profesioneve sipas kërkesës së individit pa rekomandimin e mjekut të familjes..... 300 lekë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M

Nr. 146, datë 26.2.1998

PËR NDRYSHIMIN E TARIFAVE TË TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE

Në mbështetje të neneve 2, 4 dhe 5 të ligjit nr. 7581, datë 7.7.1992, me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Punës Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Tarifat e transportit të udhëtarëve të caktuara në pikën 1 shkronja “a” dhe “b” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 498, datë 5.8.1996, dhe në pikën 1 shkronja “c” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 598, datë 20.12.1994 “Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve”, ndryshohen si vijon:

a) Tarifat e transportit qytetar të udhëtarëve me autobus në linjat me largësi deri në 9 km, të miratuara sipas kriterëve të neneve 15 dhe 16 të urdhëresës nr.7, datë 17.8.1993 “Për transportin rrugor publik të udhëtarëve dhe bagazheve”, caktohen 15 lekë për udhëtarë për një vajtje ose kthim, 330 lekë për një biletë pajtimi mujor për qytetarët dhe 180 lekë për një biletë pajtimi mujor për nxënësit dhe studentët.

b) Tarifat e transportit ndërqytetar automobilistik të udhëtarëve me autobus dhe ato ujqor liqenor) rriten mesatarisht 60 për qind.

c. Tarifat e transportit hekurudhor të udhëtarëve sipas zonave rriten mesatarisht 40 për qind.

2. Në tarifat e transportit të udhëtarëve të përcaktuara sipas pikës 1 të këtij vendimi, është përfshirë edhe TVSH-ja.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Financave të përcaktojnë me udhëzim të veçantë çmimet e reja të biletave të transportit hekurudhor sipas zonave dhe të transportit ndërqytetar e ujqor të udhëtarëve, sipas linjave dhe largësive në kilometra si kufi maksimal.

4. Tarifat e transportit të udhëtarëve të miratuara sipas këtij vendimi hyjnë në fuqi më 1 mars 1998.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M

Nr. 157, datë 26.2.1998

PËR FILLIMIN E PUNËS SË ZYRËS SË REGJISTRIMIT TË PASURISË SË

PALUAJTSHME NË DISA RRETHE

Në mbështetje të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në rrethet Tropojë, Pukë, Peqin, Kurbin, Mallakastër, Gjirokastrë, Kolonjë dhe Sarandë, me qendër në këto qytete, hapen dhe fillojnë punën zyrat e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme.

2. Veprimtaria e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në rrethet Has, Malësi e Madhe dhe Delvinë të mbulohet përkatësisht nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të rretheve Kukës, Shkodër dhe Sarandë.

3. Për rrethet Fier, Berat, Korçë, Sarandë, Mallakastër, Shkodër dhe Kurbin, këshillat e rretheve, brenda muajit mars të vitit 1998, të sigurojnë mjediset e përshtatshme prej 300m² në dispozicion të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

4. Ministria e Drejtësisë dhe kryeregjistruesi i pasurisë së paluajtshme të marrin masa për transportimin, sistemin dhe sigurimin e regjistrave të zyrave të hipotekave të këtyre rretheve pranë gjykatës së shkallës së parë, për të mbajtur të paprekura vlerat provuese dhe historike të tyre.

5. Personeli i hipotekave të këtyre rretheve të kalojë brenda strukturës organizative të zyrave të regjistrimit me urdhër të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe kryeregjistruesit të pasurisë së paluajtshme.

Numri i punonjësve të hipotekave që kalojnë pranë këtyre 8 zyrave të regjistrimit është 9 veta.

6. Ministria e Financave dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të përcaktojnë në buxhetin e vitit 1998, mbulimin e shpenzimeve për financimin e veprimtarisë së zyrave të regjistrimit.

7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Sekretariati Shtetëror për Pushtetin Lokal dhe kryeregjistruesi i pasurisë së paluajtshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M

Nr. 169, datë 6.3.1998

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 131, DATË 26.2.1998 “PËR HARTIMIN E PROJEKTIT PARAPRAK PËR REGJISTRIMIN E PËRGJITHËSHËM CIVIL TË POPULLSISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Me propozimin e Ministrit të Shtetit pranë Kryetarit të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.131, datë 26.2.1998 në pikën 3, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Ministri i Shtetit pranë Kryetarit të Këshillit të Ministrave autorizon kryerjen shpenzimeve administrative dhe përcakton masën e shpërblimit të anëtarëve të grupit të punës:”

2. Pika 5 ndryshohet si vijon:

“Sekretariatit Shtetëror të Pushtetit Lokal i akordohen 5 milionë lekë nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, për përballimin e shpenzimeve administrative për hartimin e projektit dhe shpërblimet e anëtarëve të grupit të punës, sipas autorizimeve të kryetarit të grupit të punës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr. 175, datë 6.3.1998

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 563, DATË 9.10.1995 “PËR APLIKIMIN E PUNËVE PUBLIKE”, NDRYSHUAR ME VENDIMET NR. 179, DATË 18.3.1996, DHE NR. 857, DATË 16.12.1996

Me propozimin e Ministrisë së Punëve, Çështjeve Sociale dhe Gruas, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 563, datë 9.10.1995 “Për aplikimin e punëve publike” ndryshuar me vendimet nr. 179, datë 16.3.1996, dhe nr. 857, datë 16.12.1996, në pikat 1 dhe 2 fjalët “Administrata e Përgjithshme e Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale” zëvendësohen me fjalët “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.

2. Pika 4 ndryshohet si vijon:

“Financimi i projektit përballohet nga:

a) fondet e Buxhetit të Shtetit të caktuara për punët publike;

b) burimet e brendshme të pushtetit lokal;

c) fondet shtetërore për investime;

ç) financime nga organizatat joqeveritare të vendit ose të huaja;

d) financime nga organizma qeveritarë ose joqeveritarë, të cilat, në përputhje me marrëveshjet shtetërore dypalëshe ose shumëpalëshe, administrojnë kredi a ndihma për këtë qëllim;

dh) financime të kombinuara, të përcaktuara në pikat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”.

3. Në pikën 5 bëhen këto ndryshime:

Shkronja “a” ndryshohet si vijon:

“Punimet publike të thjeshta të natyrës së pastrimeve ose sistemimeve që u jepen për zbatim pa tender njësisive ekonomike në vartësi të bashkisë a komunës përkatëse, me kusht që të përfshijnë në fuqinë punëtore individë të familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike, individë që përfitojnë pagesë papunësie, si dhe persona punëkërkues të papunë. Përcaktimi i njësisë bëhet nga zyra kompetente e punësimit, mbi bazën e rekomandimit nga bashkia ose komuna”.

- Shkronja “d” ndryshohet si vijon:

“Për punimet publike që organizohen në bashkëpunim me organizmat qeveritarë ose joqeveritarë, fondet shtetërore financojnë pagat në masën e pagës minimale”.

4. Pika 6 ndryshohet si vijon:

“Fondet e punëve publike tërhiqen në degën e thesarit, sipas situacioneve të paraqitura për këtë qëllim, të hartuara nga drejtuesi i punimeve dhe të miratuara nga kryetari i komunës a bashkisë dhe zyra kompetente e punësimit. Fondet e papërdorura nuk lejohen të kalojnë në destinacion tjetër; ato rishpërndahen nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.

5. Pika 7 ndryshohet si vijon:

“Fuqia punëtore caktohet nga zyra kompetente e punësimit. Personat nën 18 vjeç e mbi 45 vjeç dhe ata me arsim të lartë nuk vendosen në mënyrë të detyruar, por vetëm nëse deklarohen vetë vullnetarisht”.

6. Pika 10 ndryshohet si vijon:

“Shërbimi Kombëtar i Punësimit informon çdo muaj Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas për ecurinë e projekteve të punëve publike.”

7. Pika 11 ndryshohet si vijon:

“Shërbimi Kombëtar i Punësimit inspekton dhe kontrollon zbatimin e projekteve të punëve publike”.

8. Shtohet pika 14 me këtë përmbajtje:

“Krijohet Komiteti Shtetëror për Punët Publike që kryesohet nga Ministri i Punës, Çështjeve

Sociale dhe Gruas dhe përbëhet me përfaqësues nga Ministria e Financave, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Sekretariati Shtetëror për Pushtetin Lokal, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Administrata e Përgjithshme e Ndhmës dhe Shërbimeve Sociale, që caktohen nga drejtuesit e këtyre institucioneve. Komiteti ka për qëllim ndjekjen, bashkërendimin dhe propozimin e politikave të përgjithshme shtetërore për programet e punëve publike. Për hartimin e procedurave të funksionimit të këtij komiteti ngarkohet Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

- Kodi Penal (i azhornuar)
- Kodi i Procedurës Penale (i azhornuar)
- Kodi Civil (i azhornuar)
- Përmbledhje të legjislacionit në fushën e transporteve (Kodi Rrugor dhe ligji për transportet)(e azhornuar)
- Kodi Zgjedhor (I azhornuar)

U dorëzua për shtyp më 8.9.2002
Doli nga shtypi më 10.9.2002

Tirazhi: 4250 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendës së Publikimeve Zyrtare.
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë

